

VENDIM
Nr. 91, datë 19.2.2014

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 185/2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Kuvendin e Shqipërisë, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 01110 “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi”, llogaria ekonomike 606, të shtohet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh;

b) Në programin buxhetor 01120 “Veprimtaria ligjvënëse”, llogaria ekonomike 602, të zbritet fondi prej 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen administrata e Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama